



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 712 Prot.

Tiranë, më 22.052017

VENDIM Nr. 106, datë 17.05.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.8, datë 17.05.2017, pasi shqyrtoi kërkesën nga IA për vendosjen në vendimin e KKA, të veprimtarisë për Butrintin, *për projektin kërkimor shkencor në vazhdim, "Foinike – Butrint"*, me drejtues Prof. Shpresa Gjongecaj dhe Prof. Sandro de Maria, miratuar me vendim KKA NR. 71, datë 26.04.2017.

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën nga IA për vendosjen në vendimin e KKA, të veprimtarisë për Butrintin, *për projektin kërkimor shkencor në vazhdim, "Foinike – Butrint"*, me drejtues Prof. Shpresa Gjongecaj dhe Prof. Sandro de Maria, miratuar me vendim KKA NR. 71, datë 26.04.2017.
2. Në vijim të vendimit të KKA KKA Nr. 71, datë 26.04.2017, për *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Foinike – Butrint"*, drejtues Prof. Shpresa Gjongecaj dhe Prof. Sandro de Maria do të kryhen punime në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:

Në qytetin e Foinikës

- Sondazhe dhe kërkime në sektorin e agorasë helenistike dhe bazilikës paleokristiane (A23); Gërmime në pjesën lindore të kodrës (A5); Kërkimet në banjën romake (A20); Vazhdimi i gërmimeve në "Banesa me suva" (C4)
- Restaurimi i strukturave të gërmuara dhe valorizimi i sitit; Survejimi i territorit; Shkolla e arkeologjisë.
- Përdorimi i një skrepi, me qëllim pastrimin e dherave sipërfaqësore dhe spostimin e dherave nga gërmimet në kuadër të projektit.

Në Butrint

- Për vazhdimin e përditësimit të dokumentacionit në Butrint, aktiviteti kërkimor do të përqëndrohet në sistemin e fortifikimit të periudhës helenistike të qytetit.
- Rilevimi topografik i zonës me Laser Scanner dhe realizimi i planimetrive, prerjeve dhe prospekteve të integruara në shkallën 1:50; Rilevimi fotogrametrik 1:50 i sipërfaqeve arkitektonike kryesore; Analiza arkeologjike e strukturave (arkeologjia e

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS

arkitekturës); Harta e gjendjes së riskut; Hapja e ndonjë sondazhi të kufizuar në nivelin e themeleve dhe të mbështetjes së strukturave në shkëmbin natyral.

3. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë do të jetë periudha kohore e nevojëshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2017.
4. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
5. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTER



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO